

Kryetari i PDK-së, Krasniqi:
Çlirimtarët tanë po mbahen
padrejtësisht në Hagë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MARTIN DVORAK: RETORIKA AGRESIVE PO E DËMTON KOSOVËN DHE PERSPEKTIVËN E SAJ



Ministri çek për Çështjet Evropiane, Martin Dvorak, autor i librit "Kosova nën lëkurën time" dhe qytetar nderi i Istogut, ka theksuar se "retorika agresive" dhe

mungesa e vullnetit për dialog me serbët po dëmtojnë imazhin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Duke folur për situatën politike, atë të bllokadës në

Kuvendin e Kosovës, Dvorak ka thënë se udhëheqësit e Kosovës kanë nevojë për më shumë vullnet të mirë për të ndërmarrë hapa pozitivë për të bërë kompromise

OPINION

OPOZITA PA KRYE, POZITA PA TRU!

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



12 QERSHORI - DITA E ÇLIRIMTARËVE TË KOSOVËS



Lulëzim ETEMAJ

AKTUALE



RRËZOHET NJË AVION ME 242 UDHËTARË PAK PAS NISJES NGA INDIA DREJT LONDËS


EKONOMI



ZRRE-ja ZGJAT AFATIN E KEK-ut SI FURNIZUES I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR BIZNESET

ZYRTARËT E EUROSTAT-IT VIZITOJNË ASK-në

26 VJET NGA ÇLIRIMI, KOSOVA FALËNDERUES PËR ALEATET E SAJ



ABDIXHIKU PREZANTON 15 PIKA PËR QEVERINË E UNITETIT, PËRJASHTON KOALICIONIN ME PARTITË E TJERA



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rrëzohet një avion me 242 udhëtarë pak pas nisjes nga India drejt Londrës

NJU DELHI, 12 QERSHOR - Një avion i Air India, i cili po fluturonte drejt Londrës me 242 njerëz në bord është rrëzuar disa minuta pas ngritjes nga aeroporti në qytetin perëndimor të Indisë, Ahmedabad, të enjten, njoftuan kompania ajrore dhe policia, pa shpjeguar nëse ka viktima. Avioni ishte nisur drejt aeroportit Gatwick në Mbretërinë e Bashkuar, tha Air India, ndërsa oficerët e policisë thanë se ai u rrëzua në një zonë civile pranë aeroportit. Reuters ka raportuar se, në mesin e 242 udhëtarëve ishin 217 të rritur dhe 11 fëmijë. Nga këta, 169 ishin shtetas indianë, 43 britanikë, 7 portugezë dhe 1 kanadez. Sipas faqes për gjurmimin e fluturimeve, Flightradar24, avioni ishte Boeing 787-8 Dreamliner, një nga avionët e udhëtarëve më modernë në

përdorim.

“Në këtë çast po e verifikojmë hollësitë dhe do të njoftojmë për to”, tha Air India në platformën X.

Sipas kanaleve televizive, avioni u rrëzua menjëherë pas ngritjes. Një kanal shfaqti pamjet e avionit duke fluturuar mbi një zonë banimi, përpara se të zhduej nga ekrani dhe një re e madhe zjarri të ngrihej në qiell përtej shtëpive.

Sipas kontrollit të trafikut ajror në aeroportin e Ahmedabad, avioni u nis në orën 13:39 me kohën lokale nga pista 23. Ai bëri një thirrje emergjente “Mayday”, por më pas nuk u dëgjua asnjë përgjigje nga avioni. Flightradar24 tha gjithashtu se sinjali i fundit nga avioni u mor disa sekonda pas ngritjes. “Avioni i përfshirë është një Boeing 787-8 Dreamliner me regjistrim VT-ANB,” u tha në



deklaratë.

Zyra e ministrit indian të Aviacionit tha se kryeministri Narendra Modi kishte urdhëruar që të ofrohet menjëherë gjithë mbështetja për përpjekjet e shpëtimit.

Të gjitha agjencitë përkatëse janë në gjendje gatishmërie dhe po

punojnë në mënyrë të koordinuar, shtoi zyra e ministrit të Aviacionit.

Ahmedabad është qyteti kryesor në shtetin Gujarat, vendlindja e Modit.

Aeroporti i Ahmedabad njoftoi se ka pezulluar të gjitha operacionet ajrore me efekt të

menjëhershëm.

Aksidenti i fundit ajror në Indi ndodhi në vitin 2020 dhe përfshiu kompaninë Air India Express.

Avioni Boeing-737 doli jashtë në pistë në Aeroportin Ndërkombëtar Kozhikode në Indinë jugore. Ai rrëshqiti jashtë pistës, ra në një humnerë dhe u përplas me pjesën e përparme në tokë.

Në atë aksident humbën jetën 21 persona.

Air India, e cila më parë ishte në pronësi shtetërore, u ble nga kompania indiane Tata Group në vitin 2022 dhe u bashkua me Vistara - një ndërmarrje e përbashkët mes këtij grupi dhe Singapore Airlines - në vitin 2024. Tata njoftoi se ka aktivizuar një qendër emergjente dhe ka ngritur një ekip mbështetës për familjet që kërkojnë informacion.

Shqipëria avancon në procesin e anëtarësimit në BE

TIRANË, 12 QERSHOR - Qeveria e Shqipërisë tha se Bashkimi Evropian e ka ftuar të hapë negociatat për disa kapituj të grupkapitullit 4 të procesit të anëtarësimit në bllokun evropian. Sipas një njoftimi, Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm të shteteve anëtare të BE-së autorizoi Presidencën e Këshillit të Bashkimit Evropian, dhe më 11 qershor Presidenca polake i dërgoi një letër Shqipërisë duke i kërkuar që të paraqesë pozicionin negociues për katër kapituj të “Agjendës së Gjellbër dhe Ndërlidhjes së Qëndrueshme”. “Pozicioni negociues do t’i paraqitet Konferencës së Gjashtë Ndërqeveritare me Shqipërinë, e cila do të organizohet në një datë që do të shpallet së shpejti nga



Presidenca e Këshillit të BE-së”, thuhet në njoftim.

Shqipëria duhet të paraqesë pozicionin për kapitullin 14, që ka të bëjë me politikën e transportit

dhe synon përmirësimin e infrastrukturës si dhe sigurisë rrugore dhe hekurudhore. Po ashtu, për kapitullin 15 që lidhet me sektorin e energjisë dhe garantimin

e furnizimit të qëndrueshëm dhe të përbalueshëm me energji. Tirana do të paraqesë pozicionin negociues të saj edhe për kapitullin 21, që është i përqendruar në rrjetet transevropiane dhe ndërlidhjen infrastrukturore të Shqipërisë me vendet e BE-së. Po ashtu, do të negociohet edhe për kapitullin 27 i cili trajton mbrojtjen e mjedisit dhe përbalimin e ndryshimeve klimatike, përmes përputhjes me standardet e BE-së.

Qeveria shqiptare tha se ky vendim i BE-së konfirmon ecurinë e suksesshme të vendit në procesin e anëtarësimit.

Ekzekutivi në Tiranë theksoi se, përmes negociatave për këta kapituj, shteti do të ndërmarrë hapa konkretë drejt “ndërtimit të

rrugëve më të sigurta dhe moderne, përmirësimit të ndërlidhjes rajonale dhe evropiane, garantimit të furnizimit me energji të pastër dhe të përbalueshme, si dhe mbrojtjes së mjedisit për gjeneratat e ardhshme”.

Shqipëria hapi kapitullin e parë të negociatave për anëtarësim në BE në tetor të vitit 2024. Kjo ndodhi pas një pritjeje të gjatë, pasi vendi kishte aplikuar për anëtarësim më 2009 dhe kishte marrë statusin e vendit kandidat në vitin 2014.

Tirana duhet të hapë dhe të mbyllë gjithsej 33 kapituj për t’u anëtarësuar në BE. Për hapjen dhe mbylljen e çdo kapitulli kërkohet miratimi i të gjithë vendeve anëtare të bllokut evropian.

Omani thotë se rundi i gjashtë i bisedimeve bërthamore ShBA-Iran do të mbahet të dielën

MASKAT, 12 QERSHOR - Irani dhe Shtetet e Bashkuara do ta zhvillojnë këtë të diel në Oman rundin e gjashtë të bisedimeve për programin bërthamor të Teheranit, i cili po përparon me shpejtësi, tha të enjten ministri i Jashtëm i Omanit, Badr al-Busaidi. Njoftimi nga ministri al-Busaidi vjen në një kohë kur ShBA-ja po tërheq stafin që nuk konsiderohet thelbësor për operacionet në Lindjen e Mesme, si dhe të afërmit e tyre, për shkak të mundësisë së trazirave në rajon. Ndërkohë, janë bërë paralajmërime se anijet mund të

jenë shënjestër e sulmeve në ujërat rajonale për shkak të tensioneve.

Al-Busaidi e bëri njoftimin në platformën sociale X. “Kam kënaqësinë të njoftoj se rundi i gjashtë i bisedimeve Iran-ShBA do të mbahet në Muskat këtë të diel, më 15”, shkroi ai.

Irani kishte paralajmëruar disa ditë më parë se të kishte bisedime, por Omani - i cili po shërben si ndërmjetës, nuk kishte konfirmuar deri tani.

ShBA-ja nuk ka komentuar ende.

Irani e ka hedhur poshtë zyrtarisht propozimin e Uashingtonit për një

marrëveshje, duke e quajtur atë “të papranueshëm” dhe të mangët në çështje kyçe, sidomos sa i përket heqjes së sanksioneve ekonomike dhe njohjes së të drejtës së Iranit për pasurimin e uraniumit në tokën e vet.

Teherani thotë se së shpejti do ta dorëzojë një kundërpropozim përmes Omanit, një plan që e përshkruan si “të arsyeshëm, logjik dhe të baraspeshuar” dhe që u bën thirrje Shteteve të Bashkuara ta marrin seriozisht. Por, dështimi për të arritur një marrëveshje mund të çojë në përshkallëzimin e mëtejshëm të tensioneve në Lindje të Mesme,



ku tensionet janë të larta tashmë për shkak të luftës në Rripin e Gazës.

Irani dhe ShBA-ja kanë zhvilluar më parë bisedime në Muskat dhe Romë.

Kryetari i PDK-së, Krasniqi: Çlirimtarët tanë po mbahen padrejtësisht në Hagë

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, me rastin e 12 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Kosovës së bashku me bashkëpartiakë ka vizituar të enjten Prekazin. “Edhe sot, më 12 Qershor, në Ditën e Çlirimit të Kosovës, ne rikthehemi në Prekaz, sepse këtu, para së gjithash, i ka rrënjët liria. Nga këtu nisi zjarri i shpresës që ndriçoi rrugën tonë drejt çlirimit dhe pavarësisë. Në këtë datë të shenjtë të historisë sonë, kujtojmë me nderim të thellë sakrificën e Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës dhe të çdo dëshmori që dha jetën për lirinë e këtij vendi. UÇK-ja, më shumë sesa një ushtri, ishte mishërimi i aspiratës shekullore të popullit tonë për liri dhe dinjitet. Sot dhe asnjëherë tjetër, ne nuk harrojmë as miqtë tanë ndërkombëtarë - në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-n, të cilët qëndruan përkrah nesh në momentet më vendimtare të historisë sonë. Përjetësisht mirënjohës për mbështetjen!”, ka thënë Krasniqi. Ai ka thënë se mbesin me

shpresën e thellë se do të jetë i fundit ky përvjetor që e shënojnë pa ish-presidentin Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, ish-deputetin Rexhep Selimi dhe bashkëluftëtarët e tjerë. Ai ka theksuar se çlirimtarët tanë po mbahen padrejtësisht në Hagë. Krasniqi ka thënë se lufta e tyre ishte e drejtë dhe e pastër, sepse ishte lufta dhe përpjekja e një populli të tërë, që për shumë breza sakrifiko për liri. “Gëzuar 12 Qershorin - Ditën e Çlirimit të Kosovës!



Lavdi dëshmorëve dhe çlirimtarëve!”, ka pohuar Nderim Krasniqi.

ABDIXHIKU PREZANTON 15 PIKA PËR QEVERINË E UNITETIT, PËRJASHTON KOALICIONIN ME PARTITË E TJERA

EPOKA ERE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka prezantuar të enjten agjendën 15-pikëshe të Qeverisë së Unitetit, atë të tranzicionit dhjetëmuor deri në zgjedhjet e reja parlamentare. Ai ka thënë se një koalicion me fituesen e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, Lëvizjen Vetëvendosje, është i pamundur. “Për shkak të katër viteve të fundit dhe dallimeve substanciale që kemi në vlera, ky bashkëpunim ka qenë dhe mbetet i pamundur”, është shprehur ai. Para gazetarëve, Abdixhiku ka theksuar se as formimi i një qeverie nga opozita e legjislaturës së tetë nuk mund të realizohet, për shkak të mungesës së vullnetit dhe të numrave të nevojshëm. Ai ka thënë se vendi është në krizë, sepse nuk e ka shumicën dhe propozimi i tij është urgjent për të krijuar Qeverinë e Unitetit. “Po, kemi urgjencë. Ndaj, propozimi ynë është i qartë: Qeveri e Unitetit për ta nxjerrë vendin nga bllokada, për të ndërtuar stabilitet institucional, dhe për t'i dhënë zgjidhje praktike problemeve bazike të qytetarëve tanë”, është shprehur Abdixhiku, duke thënë se këto 15 pika janë konkrete, të maturuara dhe të zbatueshme. Ai ka potencuar se në këtë



drejtim nuk ka asnjë interes partiak, vetëm interes shtetëror. “Asnjë kalkulim - vetëm përgjegjësi. Në një kohë cinizmi dhe konfuzioni, ne zgjedhim të besojmë se përgjegjësia është ende e mundur. Që shteti nuk është pronë e partive, por amanet i qytetarëve. Që kriza nuk është fundi, por mundësi për të ndërtuar një fillim të ri.

Qeveria e Unitetit Kombëtar nuk është e përhershme. Por përgjegjësia që mbart - po. Është një kontratë e nderit mes forcave politike dhe qytetarëve. Për ta nxjerrë vendin nga kriza. Për ta çuar Kosovën përpara. Mund dhe ta refuzojnë. Le ta refuzojnë. Do të insistojmë. Me mendje të hapur, me idenë se jemi pjesë e zgjidhjes, jo vetëm të krizës, por

të shumë problemeve të akumuluar në vite për Republikën”, ka thënë Abdixhiku. Pesëmbëdhjetë pikat që u prezantuan nga Lumir Abdixhiku për Qeverinë e Unitetit përfshijnë funksionalizimin e institucioneve kushtetuese, dakordimin e plotë për rritjen e pagave dhe zbatimin e ligjit

përkatës, si dhe një pako emergjente për menaxhimin e krizës energjetike që përfshin edhe heqjen e TVSH-së për çdo faturë të energjisë elektrike. Ai propozoi nisjen e projektit kombëtar për gazifikimin e Kosovës, rindërtimin e raportit me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërsa brenda një shumice të tillë do të votoheshin edhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në këtë agjendë përfshihet edhe vettingu në sistemin e drejtësisë, fillimi i projekteve me rëndësi jetike për Kosovën, diskutimi për reformën kushtetuese në funksion të stabilitetit dhe hartimi i një strategjie kombëtare për reformë të thellë në arsim. Po ashtu, parashihet përgatitja për Lojërat Mesdhetare që janë në rrezik, reforma strategjike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, rishikimi i formulës për ndarjen e buxhetit për komunat, përgatitja për mbajtjen e zgjedhjeve brenda dhjetë muajve, si dhe krijimi i një mekanizmi të transparencës për periudhën kalimtare. Pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, vendi ka mbetur pa formimin e institucioneve të reja. Në Kuvendin e Kosovës ka dështuar 30 herë konstituimi i legjislaturës së re. IV-ja ka propozuar Albulena Haxhiun për kryeparlamentare, ndërsa, PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja kanë theksuar se nuk do ta votojnë Haxhiun për kryeparlamentare.

Diplomoi në mjekësi të përgjithshme vajza e Salih Mustafës, Buna

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Buna Mustafa, vajza e Salih Mustafës, i cili ndodhët në Hagë, nën mentorimin e Aurora Bakalli, mbrojti të enjten

temën e diplomës në Fakultetin e Mjekësisë të UP-së me një punim që u vlerësua lartë nga Komisioni dhe që dëshmon se ky është vetëm hapi i

parë i një rruge të gjatë të suksesshme që e pretë përpara. Me diplomimin e sotëm Buna ia bëri babait të saj në Hagë dhuratën më të

çmuar për Ditën e Çlirimit. Natyrisht ajo i bëri krenarë edhe mamanë, vëllain, familjarët e tjerë dhe gjithë të pranishmit me rastin e këtij diplomimi.





26 VJET NGA ÇLIRIMI, KOSOVA FALËNDERUES PËR ALEATET E SAJ

**EPOKA
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kosova e shënoi të enjten 26-vjetorin e Ditës së Lirisë apo Çlirimit të Kosovës, kur trupat paqeruajtëse të NATO-s hynë në Kosovë më 12 qershor 1999 pas fushatës ajrore të aleancës veriatlantike kundër caqeve ushtarake e policore serbe në Kosovë dhe Serbi. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se në këtë ditë, 26 vjet më parë, “mbi tokën e djegur të Kosovës zbarkoi shpresa: 50 mijë ushtarë të NATO-s hynë në vendin tonë të stërvuajtur duke kontribuar në çlirimin e një populli që ishte shtypur me shekuj, e mbi një milion shqiptarë u kthyen në shtëpitë e tyre”. “Luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ushtarët e NATO-s e kthyen tmerrin në guxim dhe dhimbjen në shpresë. Në atë ditë historike, ata sollën dritë pas një errësire të gjatë dhe e bënë lirinë realitet”, ka shkruar Osmani në “Facebook”. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se fitorja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe hyrja e forcave tokësore të NATO-s shënojnë ngjarjen më kulmore në historinë tonë të re. “Duke kujtuar betejat e burrave e grave të UÇK-së anekënd vendit, jemi falënderues për aleatët tanë të udhëhequr nga

Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Lirinë tonë e bëri edhe më kuptimplotë, përkrahja e bashkësisë ndërkombëtare në krye me SHBA-të dhe NATO-n, që përshpejtoi fitoren duke ndërprerë vuajtjet dhe gjenocidin që ushtrohej mbi popullin tonë. Amaneti i atyre që ranë për lirinë që e gëzojmë sot, na obligon ta ruajmë të plotë e ta zhvillojmë Kosovën!”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”. Ambasada amerikane në Prishtinë shkroi në X se në këtë përvjetor, “ne nderojmë qëndresën e popullit të Kosovës dhe përkushtimin tonë të përbashkët për ta ndërtuar një të ardhme të bazuar në paqe, siguri dhe mirëqenie”. “Sot bëhen 26 vjet që kur forcat e NATO-s hynë në Kosovë, duke sjellë shpresë, siguri dhe një rrugë drejt paqes. Data 12 qershor 1999 ishte pikë kthese - një moment që ua mundësoi familjeve të zhvendosura të kthehen dhe komuniteteve të fillojnë rindërtimin”, shkroi Ambasada amerikane. Ambasada gjermane në Prishtinë, tha se vendosja e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë - KFOR, qershorin e '99, solli stabilitet dhe siguri në Kosovë. “Siç u shpreh Lord Robertson, ish-sekretar i Mbrojtjes i Britanisë dhe sekretar i

Përgjithshëm i NATO-s: ‘Qëllimi ishte: forcat e Millosheviqit jashtë, NATO brenda dhe refugjatët të kthehen’. Misioni u përmbush”, shkroi Ambasada gjermane në “Facebook”. Ajo tha se Gjermania mbetet një nga partnerët më të ngushtë të Kosovës, duke e mbështetur në rrugën e saj drejt një të ardhmeje të qëndrueshme dhe të begatë. “Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Kosova është shndërruar në një histori suksesi, duke u rritur në qëndrueshmëri, zhvillim dhe njohje ndërkombëtare”, tha ajo. Të enjten u bënë 26 vjet nga dita kur forcat paqeruajtëse të NATO-s hynë në Kosovë, duke shënuar fundin e luftës që la më shumë se 13.500 njerëz të vrarë, kryesisht shqiptarë. Fushata bombarduese e NATO-s, që zgjati 78 ditë, përfundoi më 10 qershor 1999, pas miratimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), me kapitullimin e Serbisë dhe tërheqjen e forcave të saj nga Kosova. Rezoluta 1244 e OKB-së në Kosovë vendosi administratën e përkohshme të OKB-së, UNMIK, për të administruar me vendin e shkatërruar nga lufta, për një periudhë transitorie deri në ngritjen e kapaciteteve

vendore dhe zgjidhjen e statusit të Kosovës. Ajo, po ashtu, siguroi bazën ligjore për vendosjen e 50.000 trupave paqeruajtëse të udhëhequra nga NATO-ja për ta siguruar paqen në Kosovë, që njëherësh ishte edhe misioni më i madh paqeruajtës i Aleancës veriatlantike. Vendosjes së trupave paqeruajtëse i parapriu Marrëveshja Teknike e Kumanovës, që parashihte tërheqjen e të gjitha forcave serbe nga Kosova dhe hyrjen e trupave ndërkombëtare të NATO-s në Kosovë. Tërheqja e plotë e trupave serbe përfundoi më 20 qershor 1999. Ushtarët e parë që u futën brenda territorit të Kosovës më 1999 ishin pjesëtarë të ushtrisë norvegjeze. Ata ishin pjesë forcave paqeruajtëse nga 36 vende të botës - prej të cilëve 30.000 ishin të shteteve të NATO-s - që erdhën në Kosovë. Me hyrjen e trupave ndërkombëtare u mundësua kthimi në shtëpitë e tyre i më shumë se 800.000 refugjatëve, persona të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, të dëbuar nga shtëpitë e tyre, që po strehoheshin në kampe në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut, si dhe largimin e serbëve nga Kosova. Nga ana tjetër, tërheqja e forcave serbe çoi në shpërnguljen e rreth 164.000

serbëve nga Kosova. Ndërhyrja ushtarake e NATO-a ndodhi pas gati një dekade përpjekjesh diplomatike ndërkombëtare për t'i ndalur luftërat në ish-Jugosllavi. Në Kosovë, asaj i parapriu Konferenca e Rambujesë dhe e Parisit, ku Serbia refuzoi kompromisin që të ndalte dhunën e forcave të saj në Kosovë. Në luftën e viteve 1998-'99 janë vrarë më shumë se 13.000 persona dhe janë zhdukur më shumë se 6.000 persona. Qindra shqiptarë të vrarë nga Kosova janë gjetur në varreza masive në Serbi. Trupat e tyre janë bartur nga forcat serbe me qëllim që të fshihen krimet. Udhëheqësit politikë dhe ushtarakë të Serbisë janë arrestuar, gjykuar dhe dënuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës për ish-Jugosllavi për krimet kundër njerëzimit të kryera në Kosovë. Ndër ta ishte edhe Slobodan Millosheviqi, i cili vdiq në burg pa arritur të dënohet për përgjegjësinë në urdhërimin e krimeve të luftës në Kosovë. Sipas të dhënave, më shumë se 1.600 persona konsiderohen ende të pagjetur. Njëzetegjastë vjet pas hyrjes në Kosovë, numri i trupave të KFOR-it është zvogëluar dhe aktualisht në vend janë mbi 4 mijë trupa nga 28 shtete të botës.

12 QERSHORI - DITA E ÇLIRIMTARËVE TË KOSOVËS

Lulëzim ETEMAJ

26 vite më parë, në ditën e 78-të të sulmeve ajrore të NATO-s kundër forcave ushtarake dhe objekteve strategjike të Serbisë, në mbrëmjen e 9 qershorit 1999 në Kumanovë u nënshkrua Marrëveshja Teknike-Ushtarake. Milosheviqi dhe qeveria e tij, tanimë me barrën e rënduar të gjenocidit dhe krimeve të luftës në shpinë, pranuan kapitullimin në Kosovë. Ish-sekretari gjeneral i NATO-s, Javier Solana, me këtë rast shprehet prerazi: “NATO do të suspendojë sulmet ajrore sa më shpejtë që të verifikohet respektimi i armpushimit dhe fillimi i tërheqjes së forcave ushtarake serbe”. Kështu “mbaroj një luftë e cila ishte e drejtuar kundër vlerave perëndimore dhe civilizimit evropian...Mbaroj një luftë e cila me siguri Kosovën do ta kishte zbrazur nga popullata e saj autoktone shqiptare dhe do të kishte destabilizuar të gjitha vendet fqinje”, shkruan në ditarin e tij ish- ministri gjerman i mbrojtjes, Rudolf Scharping. Për t'u përballur me situatën e pas tërheqjes së trupave ushtarake, policore dhe paraushtarake serbe nga Kosova, ministrat e mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s pasdite arritën pëlqimin dhe i dhanë dritën e gjelbërt trupave paqësore ndërkombëtare, KFOR. Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së aprovon dërgimin e trupave të KFOR-it në Kosovë, dhe ngarkon e OKB-në, përmes Rezolutës 1244, me ndërtimin e administratës së përkohshme vendore. Më 12 qershor fillon marshimi i trupave paqësore ndërkombëtare në Kosovë. Një pjesë e trupave gjermane, të vendosura në Maqedoni, stacionohet në kufi me Shqipërinë, ndërsa një numër i tyre së bashku me amerikanët dhe britanikët përmes Shkupi marshojnë në Prishtinë. Të tjerët



përmes rrugëve të vështira malore të Shqipërisë arrijnë në Prizren. Aeroporti i Prishtinës tanimë ishte futur nën kontrollin e forcave ruse, që ishin të stacionuara në Bosnjë në përbërje të SFOR-it, të cilat kishin filluar marshimin në Kosovë që më natë. Ushtarët e Aleancës së NATO- s, ashtu si dhe ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u pritën nga qytetarët shqiptarë të Kosovës si çlirimtarë; me duartrokitje, buqeta lulesh, përqafime e lot gëzimi e shprese

në sy. Trupat paqësore ndërkombëtare, në përpjekje të krijimit të rendit dhe qetësisë, shënojnë kontakte të ngushta me komandantët e UÇK-së. Ndërsa refugjatët shqiptarë të Kosovës, të strehuar me zemërgjerësi shembullore në Shqipëri, si dhe ata në Maqedoni, s'mund t'i ndalë asgjë, as vërejtjet për rreziqet nga fushat e minuara përgjatë brezit kufitar, për t'u kthyer sa më parë në shtëpitë e tyre prej nga i kishte dëbuar dhuna serbe. Për t'u kthyer në Kosovën e lirë.

Tashmë kishte aguar dita e re, dita e parë e epokës së shumëpritur ndër breza nga shqiptarët- epokës së lirisë së Kosovës. Sot, në 26-vjetorin e çlirimit, në rrethana normale, Kosova do të duhej ta dridhte Prishtinën! Do të duhej ta ngriste fuqishëm zërin kundër abuzimit dhe deformimeve të Gjykatës Speciale. Kundër shkeljes së procedurave dhe të drejtave të njeriut të çlirimtarëve si dhe tendencave të hapura politike për ta rishkruar historinë e saj

dhe të UÇK-së. Nderim i përjetshëm luftës çlirimtare të UÇK-së, sakrificave dhe gjakut të derdhur të luftëtarëve të saj si dhe popullatës civile, të të gjitha gjinive dhe moshave! Gëzuar Kosovë! Veteranë të nderuar, gëzuar kjo ditë e shënuar! DREJTËSI PËR ÇLIRIMTARËT Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi me shokë! Lavdi e përjetshme Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

I JEPET LAMTUMIRA E FUNDIT BUJAR BUKOSHIT



PRISHTINË, 12 QERSHOR - Të enjten i është dhënë lamtumira e fundit ish-kryeministrit të Kosovës, Bujar Bukoshit. Ceremonia e varrimi të tij u mbajt në Kompleksin e Dëshmorëve në Velani. Në mbledhjen komemorative përkujtimore për jetën e tij, foli vajza e të ndjerit, Shota Bukoshi. Ajo tha se babai i saj, “aq sa ishte i saktë në skalperin e operacionit, aq ishte edhe i drejtpërdrejtë dhe i guximshëm në ndjekjen e vizionit për vendin”. “Po aq ishte mbështetës, plot dashuri dhe me humor kur ishte te ne në shtëpi”, u shpreh Shota. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, bëri homazhe të enjten pranë arkivolit të ish-kryeministrit Bukoshi, në hollin e

Kuvendit të Kosovës. Ai u shprehu ngushëllimet e tij më të thella familjarëve të të ndjerit. Në Librin e Kujtimeve, kryeministri Kurti, shkroi se dr. Bujar Bukoshi ishte kryeministër i jashtëzakonshëm, sepse kohërat ishin të tilla e njashtu edhe guximi i tij dhe atë do ta kujtojmë me nderim, kurse historianëve u mbetët ta studiojnë me kureshtje. Një ditë më parë, të mërkurën, Kuvendi i Kosovës në nisjen e seancës së 30-të konstituive, mbajti 1 minutë heshtje për ndarjen nga jeta të Bujar Bukoshit. Bujar Bukoshi vdiq më 10 qershor në moshën 78-vjeçare. Ai po vuante prej kohësh nga një sëmundje e rëndë.

Murtezaj pret në takim prokurorin Munishi: Fokus, lufta ndaj krimit ekonomik

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Drejtori i Përgjithshëm i Administ-ratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, ka pritur në takim Prokurorin e Shtetit dhe Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, Kujtim Munishi.

Takimi u zhvillua në frymën e bashkëpunimit institucional dhe me qëllim të forcimit të mëtejme të koordinimit ndërinstytucional në fushën e luftës kundër krimit ekonomik dhe evazionit fiskal.

ATK-ja ka njoftuar se gjatë

takimit, u diskutua për sfidat aktuale, si dhe identifikimin dhe ndjekjen e veprimtarive të paligjshme që dëmtojnë sistemin tatimor dhe ekonominë e vendit. “U theksua rëndësia e shkëmbimit të informatave dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale, si dhe nevoja për ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta në rastet ku identifikohen shkelje të rënda të ligjit. Drejtori Murtezaj shprehu gatishmërinë e plotë të ATK-së për të qenë një partner i besueshëm në



procesin e hetimeve financiare dhe zbatimit të ligjit, duke theksuar se lufta

kundër krimit ekonomik është ndër prioritetet kyçe të institucionit që ai drejton”, ka

njoftuar ATK-ja.

Nga ana tjetër, sipas këtij njoftimi, prokurori Munishi vlerësoi lart bashkëpunimin e deritanishëm me ATK-në dhe theksoi se bashkërendimi i veprimeve mes instituci-oneve relevante është thelbësor për të pasur një qasje më efikase dhe më të strukturuar në luftimin e fenomeneve që cenojnë rendin dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Bashkëpunimi i ndërsjellët mes dy institucioneve garanton integritet të sistemit fiskal në Republikën e Kosovës.

ZRRE-JA ZGJAT AFATIN E KEK-UT SI FURNIZUES I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR BIZNESET

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) ia ka zgjatur afatin Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) si Furnizues i Mundësisë së Fundit (FMF) për gjashtë muajt e ardhshëm, për bizneset e mëdha.

Në Kosovë të gjitha kompanitë që kanë më shumë se 50 punëtorë ose qarkullim mbi 10 milionë euro në vit u detyruan të kalojnë në tregun e hapur të energjisë nga 1 qershori.

Kjo nënkupton se ato duhet të lidhin kontratë me një nga 21

kompanitë e licencuara në vend për furnizim me energji. Kompanitë që nuk kanë arritur të lidhin kontratë, furnizohen nga KEK-u, si mundësia e fundit për furnizimin me rrymë për to. Sipas dispozitave të Ligjit për Energji Elektrike, Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është një furnizues që caktohet për një periudhë të kufizuar kohore dhe ofron shërbime furnizimi për konsumatorët të cilët nuk kanë arritur të kontraktojnë një furnizues tjetër, apo që kanë humbur furnizuesin e



tyre ekzistues.

Ky furnizues përcaktohet përmes një tenderi të hapur të shpallur nga ZRrE-ja.

Në bazë të këtij tenderi, rregullatori emëron FMF-në për një periudhë trevjeçare. Por, në rast se nuk përzgjidhet

një furnizues për atë periudhë, ZRrE-ja ka të drejtë të caktojë një furnizues të përkohshëm për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj, gjatë së cilës do të zhvillohet tenderi i ri.

ZRrE nuk ka dhënë ndonjë arsye zyrtare për zgjatjen e mandatit të KEK-ut si FMF deri më 31 janar 2026.

FMF-ja ofron gjithashtu mbështetje për konsumatorët që janë në proces të kërkimit të një furnizuesi alternativ, për një periudhë 60-ditore.



Ky zhvillim pason hyrjen në

fuqi të vendimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike. Vendimi parasheh që bizneset që i plotësojnë kriteret e përmendura duhet të zgjedhin vetë furnizuesin e tyre të energjisë në treg të lirë, me çmime të parregulluara nga institucionet shtetërore. KEK-u ka bërë të ditur se ka interesim të jashtëzakonshëm nga ana e bizneseve për të lidhur kontrata furnizimi, mirëpo nuk ka specifikuar se sa është numri i tyre.

MBAHET TRAJNIMI “ROLI I GAZETARISË NË ÇËSHTJET EVROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE: E VËRTETA, LLOGARIDHËNIA DHE LUFTA KUNDËR PROPAGANDËS”

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka organizuar një punëtori të dedikuar për gazetarët ukrainas që jetojnë dhe punojnë në Kosovë, në kuadër të programit Gazetarët në Rezidencë në Kosovë, me fokus në rolin e gazetarisë në çështjet evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe luftën kundër propagandës dhe dezinformimit.

Nën temën “Gazetaria si Fuqi e Katërt: E vërteta, Llogaridhënia dhe Ballafaqimi me Propagandën”, punëtorja shpalosi mënyrat se si gazetaria ndihmon në ndriçimin e realitetit në kohë krize, kontribuon në drejtësi tranzicionale dhe mban institucionet përgjegjëse përpara



publikut. Trajnimi u zhvillua në format interaktiv, me ligjërata dhe punë në grupe, ku gazetarët patën mundësinë të diskutojnë mbi përvojat e tyre personale dhe të eksplorojnë mjete konkrete për raportim etik dhe profesional në kontekste post-konfliktuale.

Gjatë trajnimit u trajtuan tema si roli i medias në mbrojtjen e të vërtetës dhe promovimin e llogaridhënies

në kontekstet ndërkombëtare; sfidat e raportimit në kohë krize dhe luftës kundër dezinformimit; rëndësia e gazetarisë në dokumentimin e krimeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut; praktikant nga Kosova në raportim mbi drejtësinë tranzicionale. Diskutimet e hapura dhe reflektimet grupe në fund të trajnimit shërbyen si hapësirë për

shkëmbim të përvojave mes kolegëve nga Ukraina dhe shembujve nga rajoni, duke forcuar frymën e solidaritetit dhe profesionalizmit gazetaresk në mjedis të ndjeshme. Ky aktivitet është pjesë e përkushtimit të AGK-së për të mbështetur gazetarët që punojnë në mjedis të ndjeshme dhe për të bashkëpunimin

ndërkombëtar përmes shkëmbimit të njohurive dhe përvojave.

Gazetarët ukrainas janë strehuar në Kosovë në kuadër të programit Journalists in Residence - Kosovo, program i iniciuar nga European Centre for Press and Media Freedom ECPMF dhe i implementuar nga AGK-ja.

Ky program mbështetet financiarisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe iniciativa Hannah Arendt.

Nga programi Journalists in Residence - Kosovo, deri më tani kanë përfituar 19 gazetarë nga Ukraina, prej të cilëve tetë kanë përfunduar me sukses periudhën gjashtëmuajore të strehimit në Kosovë.

Zyrtarët e Eurostat-it vizitojnë ASK-në

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) po qëndron një delegacion i Eurostat-it në një vizitë pune për të parë dhe vlerësuar zhvillimet e fundit në ASK.

Përfaqësuesja e Eurostat-it, Ellen Cathrine Kiosterud nga drejtorati B i Eurostatit u takua me drejtorin ekzekutiv, Avni

Kastrati, së bashku me udhëheqës të njëjseve përkatëse të ASK-së. Sipas programit, diskutimet do të fokusohen tek implementimi i standardeve që kërkohen sipas praktikave më të mira (Kodit të Praktikave të Statistikave Zyrtare), bashkëpunimit, si dhe për procesin e vlerësimit “Peer

Review” që do t’i bëhet ASK-së nga ana e Eurostat-it gjatë këtij viti.

Po ashtu, diskutimet do të fokusohen edhe në Regjistrimin e Popullsisë 2024 (publikimi i të dhënave), rolin e koordinimit në ASK; trajnimet e brendshme të burimeve njerëzore, ngritjen e kapaciteteve; IT dhe mbrojtjen

e të dhënave personale, cilësinë etj.

Zyrtarët e Eurostat-it do të takohen me zyrtarë të ASK-së nga njësitë e ndryshme, duke përfshirë njësitë e tregut të punës, metodologjisë, statistikave demografike, statistikave ekonomike, llogarive kombëtare, statistikave të bujqësisë dhe



mjedisit, si dhe përgatitjeve për Regjistrimin e ardhshëm të Bujqësisë.

MARTIN DVORAK: RETORIKA AGRESIVE PO E DËMTON KOSOVËN DHE PERSPEKTIVËN E SAJ

Ministri çek për Çështjet Evropiane, Martin Dvorak, autor i librit “Kosova nën lëkurën time” dhe qytetar nderi i Istogut, ka theksuar se “retorika agresive” dhe mungesa e vullnetit për dialog me serbët po dëmtojnë imazhin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Duke folur për situatën politike, atë të bllokadës në Kuvendin e Kosovës, Dvorak ka thënë se udhëheqësit e Kosovës kanë nevojë për më shumë vullnet të mirë për të ndërmarrë hapa pozitivë për të bërë kompromise



PRISHTINË, 12 QERSHOR- Kosova ka bërë përparim të jashtëzakonshëm në infrastrukturë, por ende mbetet peng i mendësisë së pasluftës dhe mungesës së kompromisit. Kështu e përshkruan gjendjen aktuale të vendit ministri çek për Çështjet Evropiane, Martin Dvorak, në ditën kur Kosova shënon 26-vjetorin e çlirimit.

Në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, Dvorak, autor i librit “Kosova nën lëkurën time” dhe qytetar nderi i Istogut, thotë se “retorika agresive” dhe mungesa e vullnetit për dialog me serbët po dëmtojnë imazhin e Kosovës në Bashkimin Evropian.

Ai bën thirrje për qetësim të situatës, rifillim të dialogut me Serbinë dhe dërgim të sinjaleve pozitive në Bruksel, duke theksuar se “pa kompromis nuk ka anëtarësim në BE”.

I pyetur se çfarë hapash konkretë mendoni se duhet të ndërmarrë Kosova tani për ta përshpejtuar rrugën e saj drejt BE-së?, Dvorak është përgjigjur: “Mendoj se është e domosdoshme të dërgohen mesazhe pozitive, sinjale pozitive. Duhet të thuhet: ‘Jemi në rrugën e duhur për të negociuar, për t’i zgjidhur problemet ose, të paktën, për ta qetësuar situatën. Jemi të gatshëm të komunikojmë për çështjen e pakicës serbe. Jemi të aftë të flasim për të drejtat e saj dhe si t’i mbrojmë ato’. Dhe, sigurisht, nga ana serbe gjithashtu duhet të kërkohet: ‘Ju lutem, hapni dyert, hapni zemrat. Filloni të punoni vërtet për bashkëjetesën, për mënyrën se si të jetojmë së bashku, dhe jo

vetëm për të nxitur urrejtje ndaj njëri-tjetrit’”, ka thënë ai.

Nga viti 1999 deri në vitin 2002, Dvorak shërbeu si administrator i Kombeve të Bashkuara në komunën e Istogut, ku udhëhoqi procesin e rindërtimit pas luftës në Istog, Gjakovë dhe rajonin e Pejës. Ai ka shërbyer gjithashtu në Irak dhe ka përfaqësuar Çekinë në SHBA, Kuvajt dhe Katar. Në qershor të vitit 2021 u emërua zëvendësministër i Punëve të Jashtme, ndërsa nga maji i vitit 2023 ushtron detyrën e ministrit për Çështjet Evropiane.

Duke folur për pajtimin mes Kosovës dhe Serbisë, Dvorak ka pohuar se të dyja palët janë të ngjuara në pozicione të forta. “E dini si thonë? Aty ku ka vullnet, ka edhe rrugë. Nëse me të vërtetë dëshiron të arrish një marrëveshje, do ta gjesh mënyrën për ta bërë. Ajo që shoh aktualisht, është se të dyja palët nuk po kërkojnë realisht një marrëveshje. Kjo është rezultat i tensioneve të gjata dhe i retorikës politike që ka ekzistuar për vite me radhë. Nuk mund ta imagjinoj asnjë politikan kosovar apo serb që thotë: ‘Shikoni, ne kemi vendosur me të vërtetë t’u japim fund të gjitha përplasjeve dhe tani do të ulemi të negociojmë sinqerisht për mënyrën se si të jetojmë bashkë’. Një deklaratë e tillë nuk do të pranohej as nga popullata në Serbi, as nga ajo në Kosovë. Pra, po flas për retorikën dhe deklaratat politike, të cilat ende nuk po çojnë drejt një zgjidhjeje të vërtetë, apo të paktën fillimit të një zgjidhjeje. Të dyja palët janë të ngjuara në pozicione të

forta: ‘Ata janë armiqtë tanë dhe nuk mund të negociojmë, nuk mund të jetojmë bashkë me ta. Nuk ka rrugë tjetër’. Unë vërtet besoj se nevojiten disa breza paqeje. Dhe ndoshta pastaj do të fillojnë të bashkëpunojnë në biznes. Ndoshta ndonjë vajzë serbe bie në dashuri me një djalë shqiptar - si Romeo dhe Zhuljeta - dhe ata fillojnë të krijojnë një familje të përzier, apo diçka e tillë. Por, për momentin, situata dhe atmosfera në të dyja anët janë tepër të ashpra dhe të ngarkuara. Prandaj, mendoj se do të duhet kohë”, ka theksuar Dvorak.

Ai ka folur edhe për gjendjen aktuale brenda Kosovës. Ai ka thënë se është një situatë vërtet paradoksale. “Nuk besoj se ndokush e mban mend ndonjëherë një situatë si kjo që po ndodh tani në Kosovë - 30 herë është tentuar të votohet kryetari i Kuvendit pas zgjedhjeve”, është shprehur Dvorak, duke shtuar se kjo tregon se situata në Kosovë është shumë, shumë e ndjeshme dhe e ndërlikuar. “Dhe më vjen keq ta them, por unë shoh mungesë vullneti të mirë. Nga këndvështrimi im, si i huaj, nëse një vend nuk është në gjendje të bëjë një hap kaq të thjeshtë, siç është zgjedhja e kryetarit të Kuvendit, atëherë si mund ta udhëheqë vendin vetë? Si mund ta çojë vendin në mënyrë pozitive drejt negociatave me Serbinë, kur deklaratat e tyre politike janë gjithçka tjetër, përveçse miqësore? E kuptoj se ata janë në garë, se po përpiqen të fitojnë sa më shumë mbështetje publike. Por,

ndonjëherë, si politikan, duhet të bësh gjëra që nuk janë të njohura apo të pëlqyera, por janë të domosdoshme. Shembulli me kryetarin e Kuvendit tregon se çfarë lloj problemi ka Kosova. Udhëheqësit kosovarë, ndonjëherë, kanë nevojë për më shumë vullnet të mirë për të ndërmarrë hapa pozitivë, për të bërë kompromis. Ky është vetëm një votim në Kuvend. Dikush duhet ta bëjë. Dhe ata ende nuk janë në gjendje. Tridhjetë përpjekje për ta zgjedhur udhëheqësin e Kuvendit! Kjo është një provë e fuqishme për atë se çfarë mund të jetë problemi - mungesa e gatishmërisë për të bërë një kompromis, i cili mund të jetë i dhimbshëm, por është i domosdoshëm në politikë”, ka thënë Dvorak.

Gjasa të pakta që Kosova të marrë statusin e vendit kandidat

Si ministër çek për Çështjet Evropiane, Dvorak ka mbështetur integrimin e Kosovës në BE. Megjithatë, skepticizmi vazhdon të jetë i pranishëm në Bruksel. I pyetur se pse po ndodh kjo?, Dvorak ka thënë se kjo është një çështje shumë më e gjerë sesa vetëm marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë.

Ai ka pohuar se Ballkani Perëndimor ka shumë probleme. “Ka pasur diskutime të gjata nëse duhet trajtuar ky rajon si një tërësi dhe të pritet një zgjidhje përfundimtare, ku të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor do të bëheshin anëtare të BE-së në të

njëjtën kohë. Por, përfundimisht, të gjithë e kuptuan që kjo nuk është rruga e duhur. Duhet të zgjedhim nxënësit e mirë, shembujt e mirë, për t’u bërë ftesë edhe të tjerëve që t’i ndjekin. Dhe, pastaj, të gjithë thonë se, për sa kohë që dialogu mes Serbisë dhe Kosovës nuk po vazhdon me fryte, nuk ka zgjidhje.

Duhet të kuptojmë, gjithashtu, se së paku pesë vende anëtare të BE-së nuk e kanë njohur ende zyrtarisht Kosovën. Edhe kjo është një komplikim shtesë në rrugën tuaj drejt Bashkimit Evropian. Nga ana tjetër, në mënyrë pozitive, mund të themi se pas pushtimit rus të Ukrainës, dëshira për të vazhduar me zgjerimin e BE-së është bërë shumë më e fortë. E kuptojmë që na duhet t’i kemi fqinjët sa më afër nesh, sa më pranë BE-së. Dhe duhet t’ju ftojme, t’ju mbajmë në anën tonë. Kjo është arsyeja pse ende po përpiqemi të negociojmë dhe po ecim në këtë rrugë për ta përfshirë Ballkanin Perëndimor. Sigurisht që kemi edhe çështjet me Ukrainën dhe Moldavinë - pjesë tjetër e diskutimit.

Por, nga këndvështrimi im personal, unë jam qytetar nderi i Kosovës dhe një mbështetës i madh i vendit tuaj. Megjithatë, mendoj se situata e tanishme është shumë e ndërlikuar që Kosova të pranohet tani si shtet kandidat. Së pari, duhet ta gjeni mënyrën se si të jetoni dhe të komunikoni me Serbinë, pastaj mund të vazhdojmë me ‘detyrat e shtëpisë’ drejt BE-së”, ka deklaruar Dvorak.

Kosova s’përbën kërcënim për sigurinë në Evropë

“Nuk mendoj se Kosova përbën ndonjë kërcënim për sigurinë në Evropë. Besoj dhe e di që vendi juaj gjithmonë ka qenë në anën e duhur të kësaj përballe, sidomos përballë Rusisë. Kosova gjithmonë ka bashkëpunuar dhe ka vepruar mirë në këtë drejtim. Për mua, Ballkani Perëndimor dhe qytetarët e Kosovës janë aleatët tanë në luftën për demokraci, për liri dhe për vlerat që ne i mbështesim. Dhe tani, ata janë nën kërcënim - ndoshta nga Rusia, ndoshta nga Kina, ndoshta edhe nga SHBA-ja, nuk e di. Nga kjo pikëpamje, besoj se mund të mbështetemi te ju. Mund të mbështetemi te Kosova dhe Ballkani Perëndimor - ndoshta jo te të gjitha vendet - që do të qëndrojnë në anën tonë, krah për krah me ne, në një situatë ku duhet t’i mbrojmë vlerat në të cilat besojmë. Nga ana tjetër, ajo që na nevojitet nga ju, është ta qetësoni situatën e brendshme”, ka thënë Dvorak.

OPOZITA PA KRYE, POZITA PA TRU!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Cirku në Kuvend: Kuvendi i Kosovës është shndërruar në vend për kanaxheqe dhe syneti. Rolin e xherrahut e ka Albin Kurthi që i ka bërë synet me kohë deputetët oborrtarë të pozitës dhe tash ka filluar edhe me opozitën. Shojja e Radoiqiut, Limoza Kulari është shkuesja kryesore për lidhje ilegale, si me Listën Serbe ashtu edhe me të luhatshmit e opozitës. E rryer për konspiracion dhe intriga, pesë herë më inteligjente se 47 deputetët e LV-së, e vetmja amazonë që mund ta shkartirat, nëse e lejon Baba, antishqiptaren dhe filogreken, nënën ideologjike të LV-së, Dejona Mihalini. Kur më herët pata shkruar për këtë karikaturë ideologjike, një hajdut veteran i KEK-ut, tash në pension më pati sulmuar fort në mbrojtje të “patriotizmit” të Dezhonës dhe grupit anarkistit të Tiranës në krye Elpis Hoxhën. Albin Kurthi po e luan lojën, me qëllim po zvarritë funksionalizimin e institucioneve, jo se nuk i bënë numrat. Për këtë arsye ka zgjedhur një “ogiq” të lodhur fare, edhe nga mosha si dhe problemet jetësore, që ta zbatojë skenarin e Kurthit për moskonstituim të Kuvendit, marionetën numër 1 që vullnetarisht po e shkelë dinjitetin për t’iu nënshtruar Liderit Suprem. Fund tmerrësisht i trishtuar. Deri më tani në mënyrë të përkryer dhe të saktë po i koordinon lëvizjet dhe veprimet me gishtërinjtë e Kurthit i cili, duke i kruar qoket, po i tërheq penjtë. Për kohën e mëvonshme, Kurthi e ka futë në lojë, Lenka Haxhiun që shkruarjen në Kuvend po e konsideron si shkuarje në kanaxheq. Është bërë “mbretëreshë” e kanaxheqeve. Opozita, pa kokë politike dhe në mungesë të parashikimit dhe planifikimit strategjik, kokë e këmbë ka rënë në kurthin e Kurthit. Në vend që të bëjë opozitarizëm aktiv, po krenohet me konstatimin se Kurthi nuk i ka numrat! Ka qenë e qartë se

opozita nuk mund të bëhet pozitë për faktin se nuk ka pasur vullnet elementar për të marrë përgjegjësi. Kryetari i LDK-së ka vendosur si kusht, del të jetë i pakapërcyeshëm, postin e KM. E kemi një abortim, jo spontan por të qëllimshëm opozitar. Kurthi është manipulues dhe shpërfillës i jashtëzakonshëm, opozita ka bërë “llogari pa hanxhinë” duke shpresuar se do ua dorëzojë pushtetin e vet do të kalojë në mriztë Zanave. Opozita e ka nënçmuar dhe shpërfillur faktin se Xhelal kaçketa tërë kohën ka punuar, me orarin e një supermarketi 24/h për emancipimin e masave. Hej, o Zot, më ruaj të mos luaj mendsh, Xhelali dhe emancipimi!!!! kur dihet se ky është....analfabet gjenial. Pse Kurthi nuk e propozoi Fatmir Limën (lima e brenë hekurin) por Lenka Haxhiun për kryetar /e të Kuvendit? Thjeshtë për faktin se Lenka i nënshtrohet pa kushte ndërsa Limaj nuk e bënë këtë, lëkurës së vet i vë çmimin më të kushtueshëm se lëkura e aligatorit të çantave Jane Birkin të Luis Vuitton. Pastaj, Kurthi i bënë llogaritë me interesin për të, jo për partinë, popullin apo Kosovën. Autokracinë e ka qëllim, faturën kryesore, marionetat, nga 1 deri në 47 i ka mjete apo profaktura për arritjen e qëllimit. Këtë nuk e ka kuptuar opozita. Që në shkrimin e parë pas zgjedhjeve kam dhënë një këshillë belesh për opozitë që ta votojnë kandidatin e propozuar nga LV-ja, për kryetar të Kuvendit dhe, në të njëjtën seancë ta votojnë qeverinë Kurthi 3. Në vend të kësaj, miopët (shkurtpamësit) opozitarë vënin kushte të cilat fort i trashnin lëngun autokratit diktatorial, Albin Kurthit. AAK-ja sillej si palë që mendonte se krejt bota po përkrahë emrat e Saranda Bogujevcit, Shqipe Selimit dhe Glauk Bin Sherifit për kryetar të Kuvendit. Dhe se krejt bota është kundër Lenka Haxhiut. Çdo deputet i LV-së, edhe ata që dinjitetin, integritetin personal, njerëzor,

kombëtar, politik dhe moral e kanë oksigjen pa të cilin nuk mbijetojnë më tepër se tre minuta (standard medicinal), siç janë Agim Bahtiri, Dimali, HAJNnullahu, Limoza, Donikë Zeza, si peci, Haxhi Qamili, Nezir Krakovina, Mefail kryetari i Pr-ës, Xhelë Stupci, Ben superhajni, kumara i Spasiqit dhe të tjerët (kërkoj ndjesë që nuk po i përmend edhe 40 të tjerë), do të sillleshin si Lenka Haxhiu prandaj është qesharake të luhet me këtë kartë. PDK-ja i përjashton 8 emra, anëtarë të qeverisë ndërsa i pranon 40 emra të tjerë. Çfarë demokracie e shpifur. LDK-ja është më parimore në këtë mishleshin opozitar, nuk e voton asnjërin kandidat që propozohet nga Kurthi. Albin Kurthi, duke e futur opozitën në kurth, po e zbaton metodën e sallamit, po e bluan opozitën duke e shndërruar në pashtetë të Meka hallall food duke i kapur të gjitha institucionet dhe pozitat në kohën kur opozita ngushëllohet me faktin se: “Kurthi nuk i ka numrat as për Kuvend e as për qeveri..”. Më tregoni çka ka bërë Kurthi kur ishte KM me mbulesë e që nuk po e bënë sot kur është vetëm deputet?! Po të votohej në seancën e parë, Kurthi me numra do të ishte pakicë dhe opozita do ta rrëzonte kur do të donte apo kur do ta vlerësonte se mund ta përkthejë në fitore politike. Kjo situatë është e përkryer për Albin Babën dhe 40.....hajnat e tij, bënë çka donë dhe nuk ka asnjë adresë të përgjegjësisë. Sipas ligjeve në fuqi, pas betimit si deputet, Albin Kurthi nuk mund të jetë kurrfarë KM, as në detyrë, as teknik e as në Hamam të Hyrës. Postin e KM në detyrë e ka, sipas ligjit, Besnik Rrenc Bislimi, kërthiza e të gjitha dallaveve në Kosovë. Asnjë ministër që është betuar si deputetë nuk ka të drejtën të shfrytëzojë zyrat apo beneficinet tjera. Të gjithë këta janë deputetë, të pozitës dhe opozitës, nuk mund të kenë poste tjera apo të marrin ndonjë vendim, madje as për treshje të

qenve të Përparim Ramës. Kur deputeti Kurti ka shkuar në zyrën që nuk i takon, edhe deputetët e opozitës është dashur të shkojnë në zyrë që gjithashtu nuk iu takon. Por, opozita nuk ka as ndjesi politike e as koçe ta bëjë këtë, vazhdon të merret në mënyrë pezhorative me cilësime për Kurthin. Besoj se nuk e keni harruar se tani Kimetja e sotit e Albinit dhe HAJNnullahut, dikur Qimetja e idiotëve (cilësim i Umberto Eccos) virtualë të Kurthit nuk pati lënë cilësim pa përdorur për Kurthin, nga ai alfabetik e deri te ai patologjik por nuk prodhoi asnjë efekt. Tash Kimi ka gjetur paqe me veten duke arritur paqe me “djallin” - Kurthin. A është kjo recetë edhe për opozitën, e shohim. Duhet ta pranojmë se dikur ishte koha e Ali Babës kurse sot është koha e Albini Babës....për hajni, jo për shtet e ndershmëri.

Kush po e “kundërshton” Gjykatën Speciale Raciste: Askush, sinqerisht përveç meje dhe një pakice të papërfillshme. Gjykata Speciale Raciste e ka arritur qëllimin duke arrestuar dhe duke dënuar UÇK-në, luftën çlirimtare dhe duke e rishkruar historinë. Gjykata Speciale Raciste e ka rehabilituar Serbinë dhe krimet e saj në Kosovë. Gjykata Speciale Raciste ka realizuar një arkitekturë politike në Kosovë duke eliminuar çlirimtarët dhe patriotët dhe duke i vendosur sabotuesit e luftës çlirimtare dhe antikombëtarët në pushtet. Tash, pasi u fal Bajrami, po dëgjohen zëra “kundërshtues” dhe “kërcënues” se, nëse do të dënohen çlirimtarët, do të bëhet kijameti. Nuk është Gjykata Speciale Raciste adresa ku do të duhej të protestohet, është Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Presidenca që duke bashkëpunuar nën rrogos me këtë Gjykatë, e sollën këtë gjendje. Këtë gjendje e sollën edhe deputetët e Kuvendit që nuk patën guxim asnjëherë ta diskutojnë në Kuvend këtë çështje. Me mosveprim, u

barazuan me qeverinë dhe presidencën. Pengjet e Hagës tash janë në mëshirën e kriminelëve juridikë të Hagës dhe antikombëtarëve të Prishtinës. Serbia po i fërkon duart. Ne po vazhdojmë të emancipohemi nga një analfabet frikacak i dhunshëm e që po e bënë trim pushteti. Çfarë i kemi bërë zotërave që na kanë mallkuar aq rëndë?!

Republika e Guantamos në Kosovë: Deputeti Albin Kurthi dhe presidentja endacake, Vojsa Osmani e kanë sjellë Kosovën në fund të pusit, me sanksione, izolim ndërkombëtar dhe varfëri etiopiane. Tash, për t’u futur nën shalët e Starmerit dhe Trampit edhe: “për vetëm pesë minuta e jo më shumë....” janë në gjendje që Kosovën ta shndërrojnë në Guantanamo duke pranuar kriminelë nga e tërë bota. Si i pari ashtu edhe e dyta a mos kanë dhënë diçka për Kosovën dhe shqiptarët, që të ndjejnë përgjegjësi dhe dhimbje?! Deri sot vetëm kanë marrë prej saj, vazhdojnë të marrin duke përfutur nga vuajtjet, gjaku dhe sakrifica e atyre që e bënë Kosovën shtet (thuaja shtet) përfshirë këtu sidomos pengjet e Hagës. Lavdia iu shkon atyre që sakrifkuan çka patën dhe çka mundën për shqiptarët, Shqipërinë dhe Kosovën, turpi bie mbi këta që e mohojnë këtë dhe përfitojnë pa dhënë asnjë kontribut.

Zgjedhjet lokale: Opozita duhet ta ketë të qartë se zgjedhjet janë para derës, duhet të mos merren fare me Kurthin dhe qeverinë por të përqendrohen te zgjedhjet lokale. Do të jetë një garë e vështirë, e paparashikueshme dhe tunduese. Opozita mund të ndahet mirë në këto zgjedhje, nëse mobilizohet seriozisht. Besoj se LV-ja do ta bëjë të pamundurën që ta ruaj bastionin e saj - Shtimen. Në shkrimin e radhës. A keni dëgjuar more ndonjëherë për emrin Adem Demaçi?

SEZONI TURISTIK NË MAL TË ZI NIS ME ÇMIME TË LARTA, BLLOKADA TRAFIKU DHE VONESA

Podgoricë, 12 qershor- Edhe pse sezoni kryesor turistik është në prag, në Mal të Zi ende nuk janë hapur të gjitha plazhet, aeroportet po funksionojnë me kapacitete të kufizuara, ndërsa kolonat në trafik maten me kilometra.

Pavarësisht premtimeve të qeverisë, as këtë sezon nuk është përmirësuar ndjeshëm qasja ajrore në Mal të Zi, e as qarkullimi nëpër kufi.

Mungon edhe zbatimi i paralajmëruar i taksës së tranzitit, që supozohej të lehtësonte ngarkesën në magjistrale nga turistët që vetëm kalojnë përmes Malit të Zi. Për shkak të vonesave në tenderët e ndërmarrjes shtetërore Morsko dobro, shumë qiramarrës plazhesh ende nuk kanë nisur punën për shkak të procedurave administrative.

Kanë kërcyer edhe çmimet - ato të akomodimit, të çadrave e shtretërve të plazhit, dhe të ofertës jashtë paketës së zakonshme turistike.

Shërbimi do të ndikohet edhe nga mungesa kronike e fuqisë punëtore, pasi ende nuk është miratuar ligji për punëtorët e përhershëm sezonalë.

E gjithë kjo po ndodh në një vit kur gjatë tre muajve të parë është regjistruar një rënie prej 10 për qind të netëve të qëndrimeve, krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa të ardhurat nga turizmi kanë rënë për 6.4 për qind.

Kjo përbën vazhdimin e një prirjeje negative nga viti i kaluar, kur për herë të parë në dy dekadat e fundit nga turizmi u fituan gati 1.5 miliard euro më pak sesa një vit më parë.

TVSH-ja dyfish më e lartë rriti çmimet e akomodimit

Shoqata Turistike e Malit të Zi (CTU) thotë se rritja më shumë se dyfish e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) për akomodim ka ndikuar ndjeshëm në çmimet e hoteleve. “Për ta kompensuar këtë ngarkesë fiskale, do të duhej të rritnim çmimet për 17.5 për qind në vit, që është e paqëndrueshme. Duke qenë se e dimë që kjo do të shkatërronte biznesin, jemi të detyruar ta përballojmë pjesërisht vetë. Megjithatë, çmimet janë rritur”, thotë kryetari i shoqatës, Zharko Radullovic, në një deklaratë për Radion Evropa e Lirë (REL).

Qeveria e kryeministrit Millojko Spajiq këtë vit e ka rritur TVSH-në për akomodimin në hotele nga 7 në 15 për qind.

Radullovic shpjegon se kjo nuk është vetëm një rritje prej 8 për qind, sepse rreth 80 për qind e të ardhurave në sektorin e hotelierisë vijnë nga akomodimi:

“Kjo do të thotë se nëse për të njëjtin numër krevatesh dhe netësh vjet kemi paguar 1 milion euro taksa, këtë vit paguajmë 2.1 milionë. Pra, barrën më të madhe të taksave po e mban pikërisht ajo që e mban të qëndrueshëm hotelierinë”.

Për ta ilustruar më mirë, ai bëri krahasime me Shqipërinë, ku TVSH-ja për akomodim është më pak se gjysma - vetëm 6 për qind.

Çfarë çmimesh i presin turistët?

Sipas të dhënave nga Organizata Turistike e Budvës, çmimet për një natë me mëngjes për dy persona në hotele me 3 dhe 4 yje variojnë nga 70 deri në 86 euro. Në hotelet me 4 dhe 5 yje, çmimet shkojnë nga 86 deri në mbi 230 euro për natë.

Ata që zgjedhin akomodim privat, paguajnë nga 16 deri në 25 euro në ditë për person. Edhe çmimet në restorantet dhe kafenetë e Budvës janë të ndryshme.

Në një zonë të njohur afër qytetit të vjetër mund të hahet mëngjes për 4.5 euro, ndërsa kafeja kushton 1.20 euro.

Pica dhe pasta kushtojnë 10 euro, kallamarët dhe rizotoja 13 euro, ndërsa peshku fillon nga 15 euro e më shumë.

Duke analizuar menytë, del se në vijën e parë të detit një drekë ose darkë kushton rreth 25 euro për person, ndërsa një ëmbëlsirë 6.5 euro.

Shtrenjtohen edhe çadrat dhe shtretërit në plazhe

Çmimet e çadrave dhe shtretërve në plazhe janë rritur ndjeshëm, pasi ndërmarrja shtetërore Morsko dobro ka trefishuar qiranë për shfrytëzimin e plazheve.

Xhavit Hoxhiq nga Ulqini thotë për REL-in se vitin e kaluar paguante 42 mijë euro për qiranë e plazhit, ndërsa këtë vit rreth 114 mijë euro - pothuajse trefish më shumë. Përveç qirasë, ai thotë se vetëm për ta pajisur plazhin rreth 200 metra të gjatë, duhet të investojë të paktën edhe 50 mijë euro. “Do të na duhet të rrisim çmimet e shtretërve, pijeve dhe ushqimit - përndryshe nuk ka gjasa që ta përballojmë këtë qira”, thotë Hoxhiq.

Sipas Shoqatës së Qiramarrësve të Plazhit të Madh, çmimi mesatar i dy shtretërve të plazhit në rivierën e Ulqinit këtë sezon do të jetë nga 17 deri në 20 euro, krahasuar me 15 - 17 euro vitin e kaluar. “Tani mbetet të shihet sa konkurrues do të jemi me këto



çmime, por kjo ishte strategjia - të merret sa më shumë nga qiratë”, thotë ai.

Ministri i Urbanizmit, Sllaven Radunovic, deklaroi në televizionin publik malazias se këtë vit shteti ka arkëtuar shtatë herë më shumë nga qiratë e plazheve krahasuar me vitin 2021 - plot 35 milionë euro.

Megjithatë, një muaj e gjysmë pas nisjes zyrtare të sezonit, shumë plazhe ende nuk janë hapur për shkak të tenderëve të vonuar.

Edhe pse deri në fund të majit 90 për qind e qiramarrësve kishin nënshkruar kontratat, shumë prej tyre ende nuk kanë leje për të punuar.

Hoxhiq thotë se për të hapur plazhin, barin veror dhe kampin, i duhet një “mal” dokumentesh, projekte urbanistike e të tjera. “Ka aq shumë letra, sa që do të na duhej deri në fund të dhjetorit për t'i kompletuar të gjitha”.

Për këtë arsye, autoritetet në Ulqin kanë propozuar që ndërmarrja Morsko dobro të japë leje të përkohshme për qiramarrësit, deri në përmbyshjen e dokumentacionit të nevojshëm. REL-i i ka pyetur autoritetet për këtë, por nuk ka marrë përgjigje.

Çfarë thonë turistët për çmimet?

Danilo dhe Ana nga Podgorica, me foshnjën e tyre, po pushojnë në një hotel të kategorisë mesatare, dhe janë të kënaqur që në plazhin afër nuk ka ende shtretër - kështu do të shpenzojnë më pak se kishin planifikuar. Por, janë të habitur

nga çmimet në markete: “Bleva një shishe ujë, patatina dhe ‘smoki’ - gjithsej 7 euro. Ndërkaq, në një piceri afër, çmimet ishin gati dyfish më të larta se në Podgoricë”, thotë Ana për REL-in. Jovani, nga Serbia, mendon se çmimet janë të arsyeshme për cilësinë që ofrohet, dhe thotë se janë më të ulëta se në Beograd, ku ai jeton: “Për mua nuk është shtrenjtë, çmimet janë në përputhje me ofertën”.

Zahra, nga Azerbajxhani, ndodhet për herë të dytë në Mal të Zi, dhe po qëndron në akomodim privat: “Disa restorante janë të shtrenjta, por ka zgjedhje, dhe mund të gesh edhe më të lira. Përshtypjet e mia janë pozitive, prandaj kam ardhur sërish”.

Transporti tokësor dhe ajror

Udhëtimi drejt Malit të Zi është ngadalësuar ndjeshëm për shkak të infrastrukturës së dobët rrugore dhe kolonave kilometrike. Disa turistë thonë se nga Dubrovniku deri në Budva, ku shkojnë shpesh, në kushte normale u duhen dy orë, por gjatë verës gjashtë deri në shtatë orë. Shkak janë pritjet në kufi, dhe punimet në Rugën e Adriatikut, mes Tivatit dhe Budvës. Veturat përshkojnë këtë distancë prej vetëm 24 kilometrash për rreth një orë e gjysmë në verë. Punimet në këtë segment prej 16 kilometrash nisën në janarin e 2024-s, dhe parashikohet të zgjasin dy vjet. Kjo rrugë është arteria kryesore e turizmit malazias, pasi lidh aeroportet e Tivatit dhe

Dubrovnikut. Ndërkohë, transporti ajror është gjithashtu problematik. Prej vitesh paralajmërohet se aeroportet në Tivat dhe Podgoricë janë shumë të vogla për të përballuar fluksin sezonal.


Në përgjigje për REL-in, kompania shtetërore Aeroportet e Malit të Zi thotë se janë “midis dy zjarreve”. “Publiku kërkon më shumë linja dhe udhëtarë, ndërsa ne punojmë në terminale që janë të njëjtë si në vitin 2006”. Në atë kohë, shtojnë ata, kanë pritur rreth 850 mijë pasagjerë, ndërsa këtë vit në të njëjtin hapësirë presin mbi 3 milionë.

Ata presin ende vendimin për dhënien me koncesion të aeroporteve, dhe për këtë arsye bëjnë vetëm investime të vogla: “Nuk është e racionale të investosh miliona, nëse ekziston mundësia që këto para të përfundojnë te dikush tjetër”. Këtë verë, Aeroporti i Podgoricës ka mbi 45 linja aktive, ndërsa ai i Tivatit mbi 50.

Qeveria kishte premtuar më herët hapjen e një linje ajrore “me interes publik”, por nuk është dhënë asnjë informacion për realizimin e këtij premtimi.

As Ministria e Turizmit nuk ka kthyer përgjigje në pyetjet e REL-it për veprimet konkrete për përmirësimin e kushteve të turizmit këtë sezon.

Fakti që turizmi përbën 25 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, por që Mali i Zi nuk ka një strategji të zhvillimit të turizmit, një plan të marketingut strategjik apo strategji për zhvillimin e burimeve njerëzore në këtë sektor - flet shumë për qasjen institucionale ndaj kësaj fushe të rëndësishme.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova synon medalje në Botërorin e xhudos

PEJË, 12 QERSHOR - Kosova do të synojë medalje të reja në Kampionatin Botëror të xhudos, i cili do të mbahet në Budapest të Hungarisë nga 13 deri më 20 qershor. Një nga ngjarjet më të mëdha të vitit në

sportin e xhudos është gati të nisë. Kampionati Botëror për seniorë, një arenë ku garojnë xhudistët më të mirë, pret 557 xhudistë nga 93 shtete, në përfaqësim të 6 kontinenteve. Kosova, shteti i medaljeve

olimpike, dotë përfaqësohet me krenari nga: Distria Krasniqi (-52kg), Laura Fazliu (-63kg) dhe Akil Gjakova (-73kg). Distria Krasniqi do të ndeshet të shtunën, Akil Gjakova të dielën, kurse Laura Fazliu do të

ndeshet të hënën. Garuesit kosovarë do të jenë nën udhëheqjen e kryemjeshtrit Driton Kuka dhe trajnerët Fatos Tabaku dhe Majlinda Kelmendi, kampionia që tani po ndërton kampionë.



Ademi: Foda ka obligime kontraktuale ndaj Kosovës

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Mediat arabe kanë raportuar se klubi i Al-Wahda është në bisedime me Franco Foda, i cili aktualisht është në krye të Përfaqësues së Kosovës në futboll. 59-vjeçari gjerman ka drejtuar Kombëtaren e Austrisë dhe ka lënë gjurmë në futbollin austriak duke fituar një herë titullin kampion të ligës dhe një herë Kupën me ekipin e Sturm Graz. Pas këtyre raportimeve ka reaguar kryetari i Federatës së

Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, i cili ka thënë se as ai e as FFK-ja nuk kanë asnjë informacion zyrtar lidhur me bisedimet mes trajnerit gjerman dhe klubit nga Meka. “Pas raportimeve se përzgjedhësi Franco Foda është pranë largimit nga posti i tij në Kombëtaren tonë, dëshiroj të informoj opinionin publik se as unë, si President, dhe as FFK-ja si institucion, nuk kemi marrë asnjë njoftim zyrtar nga përfaqësuesit e përzgjedhësit Foda apo nga ndonjë palë tjetër”, ka thënë Ademi. Më pas kreu i FFK-së

ka bërë me dije se Foda ka obligime kontraktuale dhe se me të synohet që të arrihet suksese në Kampionatin Botëror. “Foda aktualisht ka obligime kontraktuale me ne dhe presim që ato obligime të përmbushen, veçanërisht tani, në këtë fazë të rëndësishme të fushatës kualifikuese për Kampionatin Botëror, drejt së cilës shkojmë me optimizëm dhe dëshirë të madhe për sukses”, ka deklaruar Ademi. Foda në karrierën si trajner ka punuar edhe te FC Kaiserslautern dhe Zurich.



Llapi transferon Hysenin, ‘blindon’ Musollin dhe Eminin

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PODUJEVË, 12 QERSHOR - Skuadra e Llapit vazhdon të jetë aktive në kuadër të krijimit të skuadrës për edicionin e ri futbollistik. Pas largimit të Blendi Baftiut dhe Hamdi Namanit, skuadra e drejtuar nga Tahir Batatina eshte përforcuar me Hasan Hysenin. Futbollisti i njohur Hasan Hyseni do të jetë pjesë e Llapit për edicionin 2025/26. Skuadra llapjane ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me sulmuesin e krahut. “28-vjeçari vjen nga skuadra e Feronikeli '74, ku gjatë edicionit të fundit regjistroi 30 paraqitje, duke realizuar 6 gola dhe dhuruar 2

asistime. Gjatë karrierës së tij, Hyseni ka mbrojtur ngjyrat e disa klubeve të njohura në futbollin vendor, si Prishtina, Trepça '89, Malisheva dhe Drenica, duke dëshmuar vazhdimisht cilësitë e një sulmuesi të rrezikshëm dhe të shpejtë. ‘Can’ mirë se erdhe në shtëpinë tënde të re, ‘Zahir Pajaziti’! Të urojmë shumë suksese dhe sa më shumë gola me fanellën bardhekaltër”, ka njoftuar Llapi. Hyseni konsiderohet si një nga futbollistët më të shpejtë në Superligë. Shpejtësia e tij e jashtëzakonshme pritet të jetë një armë shtesë në fazën sulmuese për edicionin e ri në klubin llapjan. Ndërsa Llapi ka vazhduar bashkëpunimin me



Besar Musollin dhe Benjamin Eminin. “KF Llapi ka kënaqësinë të njoftojë vazhdimin e bashkëpunimit me mesfushorin Besar Musollin edhe për sezonin 2025/26. Musollin, një prej shtyllave të mesfushës sonë, ka qenë pjesë kyçe e ekipit në dy edicionet e fundit, duke regjistruar 68

paraqitje dhe duke dhënë kontribut të madh në fazën defansive. Vazhdimi i tij vjen si rezultat i përkushtimit të dyanshëm – si nga futbollisti, ashtu edhe nga klubi – për të ndërtuar suksese të reja së bashku. Me përvojën dhe profesionalizmin e tij, Musollin është shembull i vërtetë për futbollistët e rinj se si ndërtohet karriera profesionale me përkushtim dhe profesionalizëm”, thuhet në njoftimin e Llapit. Ndërsa me Eminin kontrata është vazhduar edhe për dy vjetet e ardhshme. “Klubi Futbollistik Llapi me kënaqësi njofton se kapiteni Benjamin Emini ka rinovuar kontratën me klubin edhe për dy edicionet e ardhshme, deri

në verën e vitit 2027. Kapiteni ynë është rritur me Llapin dhe ka qenë pjesë e rëndësishme e sukseseve të klubit vitet e fundit në kampionat dhe në garat e Kupës. Ky vazhdim është dëshmi e përkushtimit të kapitenit Emini ndaj fanellës bardhekaltër dhe vizionit të përbashkët për të udhëhequr ekipin drejt sukseseve. Me besnikërinë ndaj klubit dhe shpirtin luftarak që e karakterizojnë, kapiteni ynë mbetet frymëzim për çdo lojtar të ri që ëndërron të ndërtojë karrierë në klubin tonë”, thuhet në njoftimin e klubit që ishte finalist i Kupës së Kosovës, derisa sigurimin në Superligë e arriti vetëm nëpërmjet ndeshjes së barazhit.

Daku, afër transferimit te Zeniti

Saint Petersburg, 12 qershor - Sulmuesi Mirlind Daku është shumë pranë një hapi të madh në karrierën e tij, me transferimin te giganti rus Zenit St. Petersburg që pritet të zyrtarizohet së shpejti. Sulmuesi i Shqipërisë është në prag të

ndryshimit të skuadre gjatë merkatos së verës, por do të mbetet në elitën e futbollit rus, ku ka spikatur sezonin e fundit. Rubin Kazan ka pranuar një ofertë prej 4.5 milionë eurosh nga Zeniti, duke hapur rrugën për një nga lëvizjet më të

bujshme të kësaj vere për një lojtar shqiptar. Performanca e Dakut ka qenë mbresëlënëse: 15 gola dhe 8 asistime e renditën atë si golashënuesin e dytë më të mirë të kampionatit, duke e kthyer në një emër të kërkuar në Rusi. Zenit, nënkampionët

aktualë dhe të mbështetur nga sponsori Gazprom, po ngulmojnë për të siguruar shërbimet e sulmuesit 26-vjeçar. Nëse gjithçka shkon sipas planit, Daku do t'i nënshtrohet vizitave mjekësore të dielën për të finalizuar transferimin.




Indiana fiton në shtëpi ndaj Oklahomas, kalon në epërsi në finalen e madhe të NBA-s

Indianapolis, 12 qershor - Indiana Pacers mposhti Oklahoma City Thunder me rezultat 116:107 dhe mori epërsinë 2-1 në serinë finale të “play-off”-it të NBA-së. Skuadra nga Oklahoma e nisi më mirë ndeshjen dhe e mbylli çerekun e parë me një

epërsi prej tetë pikësh (32:24). Indiana reagoi shpejt dhe pjesa tjetër e sfidës u zhvillua me rivalitet të madh, duke ofruar emocione deri në fund. Pacers morën avantazhin vendimtar rreth katër minuta para fundit, kur

kaluan në epërsi 107:100 dhe e menaxhuan me qetësi deri në fitore. Bennedict Mathurin shkëlqeu për Indianan me 27 pikë, ndërsa Tyrese Haliburton kontribuo i me 22 pikë, nëntë kërcime dhe 11 asistime. Pascal Siakam e mbylli ndeshjen e

tretë finale me 21 pikë të tjera. Te Oklahoma, më të mirët ishin Jalen Williams me 26 pikë, Shai Gilgeous-Alexander me 24 dhe Chet Holmgren me 20 pikë. Ndeshja e katërt e serisë do të zhvillohet në orët e vona të së premtes, në kalimin për



në të shtunë ku sërish do të luhet në Indiana.

Tare synon transferimin e Xhakës dhe Brojës

MILANO, 12 QERSHOR - AC Milan është duke u përgatitur për transferime. Mesfushori aktual i Bayer Leverkusen, Granit Xhaka, është një prej lojtarëve të preferuar të drejtorit sportiv, Igli Tare, i cili kishte tentuar vite me parë ta transferoj edhe në Lazio. Mesfushori mbetet një nga prioritetet e Milanit, megjithatë vlera e tij e konsiderueshme, midis 15 dhe 20 milionë eurove, si dhe kontrata deri në vitin 2028 me Leverkusenin, e bëjnë transferimin një sfidë të vërtetë. Sipas raportimeve të “Calciomercato.com”, Milani po ndjek një strategji pritjeje në lidhje me këtë çështje. Igli Tare dëshiron të presë fillimisht rezultatet e bisedimeve që do të zhvillohen së shpejti midis Granit Xhakës dhe trajnerit të ri të Leverkusen, Erik Ten Hag. Mesfushori, që me Xabi Alonso në stol ishte një element kyç në skuadër, dëshiron të kuptojë planet që trajneri i njohur ka për të në ekip. Në këtë mënyrë, Milani do të niste përpjekjet serioze për transferimin e Xhakës vetëm nëse do të ketë një sinjal të qartë pozitiv, si nga ana e



vetë lojtarit, ashtu edhe nga Bayer Leverkusen. Deri atëherë, kuqezinjtë do të vazhdojnë të monitorojnë situatën me kujdes dhe të mendojnë edhe për opsione të tjera për mesfushën e tyre. Por Granit Xhaka nuk është i vetmi shqiptar që Igli Tare është duke ndjekur me vëmendje. Ai gjithashtu është duke konsideruar mundësinë për të transferuar në Milano edhe talentin kuqezi, Armando Broja. Këtë të fundit, Tare e ka ndjekur nga afër në sfidën Shqipëri-Serbi



ku bëri një paraqitje të mirë. Brojës do t'i krijohej një hapësirë te Milani në rast se Luka Jović do të merrte vendimin përfundimtar për mos qenë më pjesë e kuqezinjve. Megjithatë, për momentin është raportuar se Igli Tare është vetëm në proces monitorimi të situatës së Armando Brojës dhe ende nuk është marrë një vendim përfundimtar nëse do të nisë negociatat me Chelsea për të sjellë talentin kuqezi në Milano apo jo.

Verstappen: Gara e Barcelonës ishte një zhgënjim, asgjë nuk është e mbyllur në Botëror

MONTREAL, 12 QERSHOR - Rikuperimi i 49 pikëve nga Oscar Piastri dhe 39 nga Lando Norris nuk është i lehtë për askënd, madje as për katër herë kampionin e botës në Formula 1, Max Verstappen. Gara e radhës është në Montreal, pistë ku holandezi i Red Bull ka fituar tre edicionet e fundit. Verstappen duhet të marrë disa rreziqe dhe të jetë agresiv për t'u rikuperuar. “Gara e Barcelonës ishte një zhgënjim për ne dhe, nuk shkoi ashtu siç do të donim. Po presim



me padurim Kanadanë, një pistë unike dhe ka shumë mundësi parakalimi”, ka thënë Verstappen. “Përshtatja e makinës do të jetë e rëndësishme dhe është gjithmonë një sfidë më e madhe

me zonat e mëdha të frenimit. Gara e vitit të kaluar ishte shumë emocionuese, ne arritëm të fitonim dhe shpresojmë se mund të marrim një performancë pozitive përsëri këtë vit”, ka shtuar holandezi. “Ne duhet të bëjmë një kualifikim më të mirë dhe kemi punuar për këtë. Moti në Kanada mund të jetë befasues, por duket se mund të jetë mjaft i thatë dhe i qëndrueshëm për një herë, gjë që duhet të na ndihmojë të arrijmë qëllimet tona”, ka deklaruar Max Verstappen.

SHKURT

Hoxha kërkohet nga Hull City, Lecce dhe disa klube turke

Sulmuesi i Kombëtares shqiptare, Arbër Hoxha, pritët të largohet nga Dinamo Zagrebi. Kështu të paktën kanë raportuar së fundmi mediat kroate. Dinamo Zagreb po ndërpret bashkëpunimin me shumë lojtarë, ndërsa i radhës mund të jetë Hoxha. Raportohet se ka disa skuadra evropiane që kanë shprehur interesim për 26-vjeçarin. Anglezët e Hull City, që për trajner emëroi boshnjakun, Sergej Jakiroviç, ka shprehur interesim për Hoxhën. Kajserispori i elitës turke është po ashtu i interesuar. Prej Turqisë, Hoxha është edhe në radarin e Trabzonsporit dhe Ejupsporit, shkruan Panorama. Më herët për futbollistin e Kombëtares shqiptare, Arbër Hoxha kanë shprehur interesim edhe skuadra italiane si Lecce.

Ja shuma e majme që arkëtuan fituesit e grand slam të Roland Garros

Grand slam i Roland Garros ka ulur të dielën e kaluar siparin, por sa para kanë fituar tenistët në këtë turne? Turneu francez ka kohë që ka vendosur një premio të njëjtë si te femrat ashtu dhe te meshkujt. Në total, për turneun më të rëndësishëm të fushave me dhe kanë qenë 56.3 milionë euro në dispozicion të tenistëve. Fituesit arkëtuan 2.55 milionë euro, ndërsa finalistët nga 1.27 milionë euro, një rekord për këtë turne. Tenistët që shkuan deri në gjysmëfinale arkëtuan 690 mijë euro, ndërsa çerekfinalistët 440 mijë euro. Çmimet kanë qenë në rritje nga viti në vit edhe në tenistët e eliminuar në raundet më të ulta. Tenistët e eliminuar në raundin e parë morën 78 mijë euro: ata që u eliminuan në raundin e dytë morën 117 mijë euro; në raundin e tretë 168 mijë euro dhe ata që u eliminuan në raundin e katërt morën 265 mijë euro.

Al Nassri me ofertë marramendëse për Spallettin

Trajneri Luciano Spalletti që u shkarkua ditë me parë nga detyra e trajnerit të Italisë ka përfunduar në syrin e Al Nassrit. Ish-komisioneri teknik u bë menjëherë një nga trajnerët më të rëndësishëm në treg dhe siç raportohet nga “Gazzetta dello Sport”, propozimi i klubit arab mbërriti menjëherë nga Arabia Saudite, e cila duhet të gjejë një trajner të ri duke pasur parasysh ndarjen e afërt me Stefano Piolin, gati për t'u kthyer në Itali. Në ditët në vijim, Al Nassr do të ndërpresë kontratën prej rreth 12 milionë dollarësh në sezon me Piolin, më pas do të kenë mundësinë të zyrtarizojnë propozimin për Luciano Spallettin.

Befason Sane, transferohet në Galatasaray

Ylli i Kombëtares së Gjermanisë, Leroy Sane mbërriti në Stamboll me një pritje spektakolare, duke ndezur entuziazmin mes tifozëve. 29-vjeçari zbriti nga avioni privat në qytetin turk me

një shall të Galatasarayit të varur me krenari rreth qafës. Me kontratën e tij me Bayern Munich që skadon në fund të muajit, Sane i bashkohet skuadrës turke si lojtar i lirë. “Kisha shumë oferta, por

Galatasaray më impresionoi më së shumti. Atmosfera, madhështia e klubit dhe dëshira që kishin për mua bënë diferencën. Jam shumë mirënjohës tifozëve që erdhën në këtë orë. Kjo do të thotë

shumë për mua dhe mezi pres ndeshjen time të parë para tyre”, ka thënë Sane. Anëtori gjerman pritët të përfitojë një pagë neto vjetore deri në 15 milion euro në Stamboll. Ndërkohë, Bayern Munich thuhet se po kërkon

disa zëvendësues, duke përfshirë spanjollin Nico Williams nga Athletic Bilbao, Rafael Leao nga AC Milan, Christopher Nkunku nga Chelsea dhe Bradley Barcola nga Paris Saint-Germain.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të datës 11.06.2025 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 13.06.2025 të shpall:

KONKURS TE BRENDSDHEM

Faturist/e- në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi. Numri i referencës: 11-06-111
Përgatitja profesionale:Përgatitje Universitare (Fakulteti Ekonomik i preferuar)
Përvoja e punës:Së paku një (1) vit përvojë pune
Lartësia e pagës mujore: 410.64 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bënë llogaritjen dhe shtypjen e faturave sipas shenimeve dhe çmimeve valide të sektorit të amvisërisë dhe sektorit komercial.
- Mban evidencën mbi ndryshimet dhe specifikacionet nga fushëveprimtaria e punëve dhe detyrave të punës, si dhe dëshminë mbi dorzimin e faturave manipulantve për procedurë të mëtejme (Dergimin e faturave blerësve) ,
- Regjistron, udhëheq analitiken e blerësve nga arka në terene (inkasantave) dhe ekstraktet bankare, kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të eprorit drejtëpërdrejtë.

Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës). Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe ne bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë. Kandidatë fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit. Kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë ne çdo fazë të procedurës se rekrutimit , ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejta të shqyrtohet nga Komisionni i Ankesave.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Cv- në
- Dëshmi për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Dëshmi për përvojën e punës
- Kopja e leternjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes.
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj).

Afati dhe mënyra e Aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 13.06.2025 deri me 27.06.2025, ora 16:00. Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M ."Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të datës 11.06.2025 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 13.06.2025 të shpall:

KONKURS

Një (1) Punëtor Fizik - Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi. Numri i referencës: 11-06-112
Përgatitja profesionale: Shkolla fillore e preferueshme
Lartësia e pagës mujore: 432.36 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës). Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe ne bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë. Kandidatë fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit. Kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë ne çdo fazë të procedurës se rekrutimit , ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejta të shqyrtohet nga Komisionni i Ankesave.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e leternjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes.
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj).

Afati dhe mënyra e Aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 13.06.2025 deri me 27.06.2025, ora 16:00. Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M ."Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “B&G Fashion Group” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811991323 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “B&G Fashion Group” L.L.C. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811991323 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “B&G Fashion Group” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811991323 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Dr. Ilire Zajmi Pazhari nga Gjakova shpall të pavlefshme kartelën e Odës së Mjekëve me nr. KO-05260-01-06 të lëshuar nga OMK.

- Lumnije Pepshi nga Juniku shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. “Edmond Hoxha”, Junik. Nga klasa e 1-8.

- “Taboo Bar” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811312735 si dhe certifikatën e TVSH-së, me nr. 330422858.

- “Taboo Bar” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330422858.

- Vedat Gajraku shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m. Prizren “11 Marsi”.

- Antigona Abrashi shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Elvana Zherka shpall të pavlefshme diplomën e shme “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dymuaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1903

Columbus, Georgia, USA
Since 1903

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

